URDHËR
Nr. 279, datë 25.5.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Drejtësisë, për datën 26.5.2026, te zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Elona Hoxha.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Drejtësisë, znj. Elona Hoxha, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Toni Gogu